



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE

VENDIM
Nr. 5, Dt. 11.06.2009

Per miratim te kerkeses per marrje leje, per perdorim uji, prej burimit ujore te lumit te Langarices(dege e lumit Vjose), per prodhim te energjise elektrike nepermjet HEC-it, te Langarices, prej subjektit "Hasi Energji" sh.p.k, Gjirokaster.

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "*Hasi Energji*" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per "Koncesionet", V.K.M nr.27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve" vendimit nr.3, dt. 19.07.2002 te K.K.D-se, "Per miratimin e rregullores te sekretariatit Teknik" te K.K.U-se, te K.B.U -se , udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, Vendimit nr.476, dt. 06.05.2009 te K.M "Per miratimin e kontrates koncesionare te formes ROT", ndermjet M.E.T.E. dhe nga ana tjeter shoqerise "Hasi Energji" sh.p.k. Gjirokaster, per ndertimin e HEC-et Largarica 1 dhe Largarica 2 si dhe vendimit nr.4 date 25.09.2008 te K.B.U Vjose.

Duke mare ne konsiderat kerkesen e shoqeris "Hasi Energji" sh.p.k. si dhe marveshjen e dates 25.04.2009 lidhur ndermjet M.E.T.E dhe shoqerise "Hasi Energji" shpk e cila miraton reduktimin e numrit te HEC-eve Largarica 1 dhe Lngarica 2, ne nje te vetem, HEC Largarica.

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

1. Miratimin e kerkeses te bere nga shoqeria "Hasi Energji" sh.p.k, Gjirokaster per dhenje leje, "Per perdorim te ujit" per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it te Langarices, ne lumin e Langaric.
2. Miratohet reduktimi i dy HEC ne nje HEC me nje veper marrje, e cila do te jete ne vendin me koordinata:
X = 44 54 690 Y = 44 58 595 Z = 410 m

Vazhdon vendimi nr. 5

3. Sasia e ujit qe jepet ne perdorim, per prodhim te energjise, per HEC-in e Langarices do te jete $8 \text{ m}^3/\text{sek}$.
4. Periudha e perdorimit te ujit do te jete gjate gjithë vitit, perjashto periudhen nga 1 Maji- deri ne 31 Gusht te cdo viti, ku prurjeve te mesiperme te ujit, do tu zbriten sasia e ujit qe do te perdoret per ujitjen e kulturave bujqesore - $0.2 \text{ m}^3/\text{sek}$
5. Ngarkohet A.U.B "Vjose" per zbatimin e ketij vendimi.
6. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere .

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"
Vezi METAJ



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

